



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 105, dhe 118 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Aktgjykimin të Gjykatës Supreme AA.nr.63/2021, të dorëzuar në KQZ më datën 10.11.2021, Nr.3071/2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 11.11.2021, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet rekomandimi i QNR-së që të vërtetojë plotësisht si dhe saktë numrin e votave të fituara të kandidatit Dardan Krasniqi, nga subjekti politik "Demokratët për Drenasin", në bazë të Formularëve të Rezultateve të Kandidatit, në të gjitha vendvotimet e Komunës së Drenasit, si dhe të njëjtat të përfshihen në rezultatin përfundimtar duke vërtetuar saktë rezultatet në të gjitha vendvotimet e Komunës së Drenasit, sipas Aktgjykimin të Gjykatës Supreme AA.nr.63/2021, të dorëzuar në KQZ më datën 10.11.2021, Nr.3071/2021,
- II. Rekomandimi i QNR-së është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Rezultati pas vërtetimit si në pikën I, të përfshihet në rezultatet përfundimtare.
- IV. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Arsyetim

Duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme AA.nr.63/2021, të dorëzuar në KQZ më datën 10.11.2021, Nr.3071/2021, lidhur me ankesën e parashtruar nga kandidati Dardan Krasniqi, nga subjekti politik "Demokratët për Drenasin", me seli në Drenas, përkitazi me vendimin e PZAP-së Anr.1062/2021, të datës 05.11.2021, duke urdhëruar KQZ-në që të rishqyrtoj vendimin nr.2948/2021, të datës 03.11.2021, vetëm për kandidatin e Dardan Krasniqi, dhe të vërtetojë plotësisht si dhe saktë numrin e votave të fituara nga kandidati i sipër përmendur, në bazë të Formularëve të Rezultateve të Kandidatit, në të gjitha vendvotimet e Komunës së Drenasit, si dhe të njëjtat të përfshihen në rezultatin përfundimtar duke vërtetuar saktë rezultatet në të gjitha vendvotimet e Komunës së Drenasit. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 11.11.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Datë / Datum	11.11.2021	Referencë/e	
Për/ Za	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve		
Nga/ Od	Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së		
Tema/ Subjekat	Raport i aktiviteteve të Sekretariatit të KQZ-së		

- Rinumërimi i fletëvotimeve të kutive të votimit, sipas vendimit të PZAP

Procesi i rinumërimit të fletëvotimeve sipas vendimit të PZAP dhe vendimit të KQZ-së, ka filluar në ndërrimin dytë me datë 08 nëntor 2021. Procesi është duke vazhduar dhe deri me datë 11.11.2021, ndërrimi i parë, nga rreth 620 kuti të votimit, prej tyre janë rinumëruar 321 kuti të votimit ose 51.77% ndërsa në proces janë 32 kuti të votimit. Procesi i rinumërimit është duke u berë në 2 ndërrime në 20 Tavolina të rinumërimit. Mesatarja e kutive të votimit të cilat janë duke u rinumëruar, brenda një ndërrimi është 58 kuti të votimit për ndërrim.

Datë	Ndërrimi	Gjithsej Vendvotime	Vendvotime për	Vendvotime për	Vendvotime për	Gjithsej për	Vendvotime të	Në proces	Gjithsej	Përqindja
			rinumërim (PZAP) 08.11.2021	rinumërim (PZAP) 09.11.2021	rinumërim (PZAP) 10.11.2021	rinumërim PZAP	rinumëruara në QNR			
08.11.2021	Ndërrimi 2	2477	467	153	0	620	48			10.28%
09.11.2021	Ndërrimi 1			0	0		59			12.63%
09.11.2021	Ndërrimi 2			0	0		63			13.49%
10.11.2022	Ndërrimi 1			0	0		66			14.13%
10.11.2022	Ndërrimi 2						61			13.06%
11.11.2022	Ndërrimi 1						24	32	56	9.03%
	Gjithsej		467	153	0	620	321	32	353	56.94%

Raporti i progresit të rinumërimit në QNR 11112021-1200

Rekomandim për rinumërimin e fletëvotimeve sipas vendimit të Gjykatës Supreme

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 10 nëntor ka pranuar vendimin nga Gjykata Supreme lidhur ankesën ndaj vendimit A.nr. 1062/2021 të PZAP dhe urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të rishqyrtojë vendimin nr. 2948/2021 të datës 3 nëntor 2021, dhe të vërtetojë numrin e saktë të votave të fituara të kandidatit Dardan Krasniqi nga SP, Demokratët për Drenasin, vetëm përkitazi me kandidatin e sipër përmendur dhe të vërtetojë plotësisht si dhe saktë numrin e votave të fituara nga ai, në bazë të Formularët e Rezultateve të Kandidatit, në të gjitha vendvotimet e Komunës së Drenasit, si dhe të njejtat të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

Rekomandim 1:

Me qëllim të zbatimit të vendimit të Gjykatës Supreme, por edhe me qëllim të saktësisë së votave të të gjithë kandidatëve në ato vendvotime, rekomandohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të bëhet rinumërim i plotë për të gjitha vendvotimet sipas vendimit të Gjykatës Supreme duke vërtetuar saktë rezultatet në të gjitha vendvotimet e Komunës së Drenasit.

Rekomandim 2:

Me qëllim të zbatimit të vendimit të Gjykatës Supreme, por edhe me qëllim të saktësisë së votave të kandidatit Dardan Krasniqi, nga SP "Demokratët për Drenasin", rekomandohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të vërtetojë plotësisht si dhe saktë numrin e votave të fituara nga kandidati i sipër përmendur, në bazë të Formularëve të Rezultateve të Kandidatit, në të gjitha vendvotimet e Komunës së Drenasit, si dhe të njejtat të përfshihen në rezultatin përfundimtar duke vërtetuar saktë rezultatet në të gjitha vendvotimet e Komunës së Drenasit.

W_o